

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-369/2022	Data: Datum: 01.06.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 01.06.2022 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: “Hartimi i projekteve për infrastrukturë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-4213-2-1-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-014-211, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: “Hartimi i projekteve për infrastrukturë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-4213-2-1-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-014-21, dhe në komision caktohen:

- 1.1. Arta Fetahu,** Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
- 1.3. Driton Alihajdaraj,** Zyrtarë i Lartë i Prokurimit, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit: “Hartimi i projekteve për infrastrukturë”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-370/022	Data: Datum: 01.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.120-19863 të datës 20.05.2022 të parashtruar nga Agron Hakaj nga fsh. Orrobërdë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Fatmusha Hakaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01 Nr.120-19863 e datës 20.05.2022 e parashtruar nga Agron Hakaj për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Fatmusha Hakaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Agron Hakaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Agron Hakaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-371/022	Data: Datum: 04.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05-553-19698 të datës 19.05.2022 të parashtruar nga Ajdin Salijaj nga fsh. Shushicë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, për djalin Imer Salijaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.05-553-19698 e datës 19.05.2022, e parashtruar nga **Ajdin Salijaj** për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për djalin Imer Salijaj si nxënës i rregullt në SHMLP "Mithat Frasheri" në Gurrakoc, për gjysmëvjetorin e dytë shkollor të vitit 2021/22, relacioni Shushicë-Gurrakoc dhe anasjelltas, i ndahen **100€ (njëqind euro)** nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e babait Ajdin Salijaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria Komunale për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ajdin Salijaj, ka parashtruar kërkesë Nr.05-553-19698 të datës 19.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për djalin Imer Salijaj si nxënës i rregullt në SHMLP "Mithat Frasheri" në Gurrakoc për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2022.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Ajdini e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnjë burim të rregull të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi me i mbuluar shpenzimet e udhëtimit për djalin.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë Komunale për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik subvencione dhe transfere, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet financiare të përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Ajdin Salijaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ajdin Salijaj,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-372/022	Data: Datum: 01.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Para universitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria Komunale për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05-553-21374 të datës 31.05.2022 të parashtruar nga znj.Azize Fekaj nga fsh. Kërrninë Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën Erona Fekaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.05-553-21374 e datës 31.05.2022 e parashtruar nga znj.Azize Fekaj për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën Erona Fekaj si nxënëse e rregullt në Gjmnazin "Haxhi Zeka" në Istog, për gjysmëvjetorin e dytë shkollor të vitit 2021/22, relacioni Kërrninë-Istog dhe anasjelltas, i ndahen **100€ (njëqind euro)** nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e nënës Azize Fekaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria Komunale për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Azize Fekaj ka parashtruar kërkesë Nr.05-553-21374 të datës 31.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën Erona Fekaj si nxënëse e rregullt në Gjmnazin "Haxhi Zeka" në Istog për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021/2022. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Azizja e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnjë burim të rregull të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi të mbuluar shpenzimet e udhëtimit për vajzën.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë Komunale për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik subvencione dhe transvere, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Azize Fekaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Azize Fekaj,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-373/2022	Data: Datum: 01.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-19929 të datës 23.05.2022, të parashtruar nga znj.Xheva Ademaj nga fsh. Lubovë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj për rrezatime në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-19929 e datës 23.05.2022, e parashtruar nga znj.Xheva Ademaj për përkrahje me karburant për dërgimin e saj për rrezatime në QKUK në Prishtinë dhe i lejohen **280 litra karburant**.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që të pajisë Xheva Ademaj me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit deri në përfundimin e trajtimit-rrezatimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Xheva Ademaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-19929 të datës 23.05.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj në QKUK në Prishtinë për rrezatime.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Xheva është i sëmurë dhe ka nevojë për rrezatime sipas raportit të lëshuar nga QKUK dhe i ndihmohet me 280 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për rrezatime në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për rrezatime në Prishtinë.

Zyrtari i transportit Xheven do të pajisë për çdo javë më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Xheva Ademaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-374/2022	Data: Datum: 01.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-18745 të datës 13.05.2022, të parashtruar nga z.Vesel Zymeraj nga fsh. Serbobran, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes Miana Zymeraj për trajtimin e sëmundjes në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-18745 e datës 13.05.2022, e parashtruar nga z.Vesel Zymeraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes Miana Zymeraj në QKUK në Prishtinë për trajtimin e sëmundjes së tumorit dhe i lejohen **50 litra karburant**.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që të pajisë Vesel Zymeraj me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit deri në përfundimin e trajtimit-rrezatimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Vesel Zymeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-18745 të datës 13.05.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i Miana Zymeraj në QKUK në Prishtinë për trajtim e sëmundjes së tumorit.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Miana është e sëmurë dhe ka nevojë për trajtimin e sëmundjes sipas raportit të lëshuar nga QKUK dhe i ndihmohet me 50 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj në QKUK.

I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për trajtim e sëmundjes në QKUK.

Zyrtari i transportit Veselin do të pajisë për çdo javë me vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Vesel Zymeraj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-376/022	Data: Datum: 03.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në Vendimin A.Nr.401/2022 të datës 26.05.2022 të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që komuna të kthej Lulzim Blakaj në vendin e punës, nxjerri:

V E N D I M

- 1. Lulzim Blakaj**, kthehet në vendin e punës në Komunën e Istogut sipas Vendimin A.Nr.401/2022 të datës 26.05.2022 të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa obligohet Menaxheri i Personelit të kthej në vendin e punës sipas Akt Emërimit apo në një pozitë tjetër ekujvalente nëse pozita që e ka mbajt nuk është e lirë.
- I lartpërmenduri ditën e nënshkrimit të Akt Emërimit mund të filloj me detyrat e punës sipas pozitës së vendit të punës të caktuar nga Menaxheri i Personelit.
- Obligohet Menaxheri i Personelit që me Akt Emrim të njoftoj Zyrtaren Financiare-Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime për futjen në listën e pagave të Lulzim Blakaj.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Menaxheri i Personelit.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Lulzim Blakaj;
- Menaxherit të Personelit; dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-377/022	Data: Datum: 03.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-16963 të datës 04.05.2022 të parashtruar nga Xhavit Demaj nga fsh. Vrellë, Komuna Istogu për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-16963 e datës 04.05.2022 e parashtruar nga Xhavit Demaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00€ (treqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Xhavit Demaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Xhavit Demaj, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-16963 të datës 04.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Xhavit Demaj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **300.00€ (treqind euro)**.

Në plan programin buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Xhavit Demaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-380/2022	Data: Datum: 06.06.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, për themelimin e komisionit për dalje në vendngjarje për verifikimin e gjendjes së rasteve të strehimit social të cilave komuna jua benë pagesën e qirasë së banimit, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për dalje në vendngjarje për verifikimin e gjendjes së rasteve të strehimit social të cilave komuna jua benë pagesën e qirasë së banimit dhe në komision caktohen:

- 1.1. Abedin Neziraj,** Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitete, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Naser Nimanaj,** Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar dhe
- 1.3. Merita Bytyçi,** Drejtoresh e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të del në vend ngjarje në afatin me të shkurtër kohorë dhe të bëjë verifikimin e gjendjes për të gjitha rastet e strehimit social të cilave komuna jua benë pagesën e qirasë së banimit; të hartoj procesverbal duke përshkruar gjendjen aktuale të secilit rast, do të bëjë raport për të gjitha rastet; do të njoftoj Kryetarin me raportin përfundimtar me gjendjen e rasteve të strehimit social si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01Nr.383/022	Data Datum: 07.06.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe bazuar në Raportin e Auditimit të Komunës së Istogut për vitin fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për themelimin e Grupit punues për hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit për vitin fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2021, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Grupi punues për hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit për vitin fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2021 dhe në grupin punues caktohen:

- 1.1. Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës, Kryesues i Grupit Punues;
- 1.2. Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit Komunal, anëtar;
- 1.2. Osman Sadikaj, Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa, ZKF, anëtar;
- 1.3. Genc Ademaj, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar;
- 1.4. Abedin Kabashi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar;
- 1.5. Naïm Behlulaj, Drejtor i Drejtorie Komunale për Arsime, anëtar;
- 1.6. Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar;
- 1.7. Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, anëtar;
- 1.8. Agon Dreshaj, Drejtor i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi, anëtar;
- 1.9. Kushtrim Buleshkaj, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar;
- 1.10. Elian Blakaj, Drejtoresh e Drejtorisë për Kulturë, Rin i dhe Sport, anëtare;
- 1.11. Riza Alihajdaraj, Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm, anëtar;
- 1.12. Adem Avdiaj, Përfaqësues Ligjor i Komunës, anëtar;
- 1.13. Fatmir Bytyqi, Menaxher i Personelit, anëtar;
- 1.14. Hatixhe Arifaj, Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, anëtare;
- 1.15. Rasim Mahmutović, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
- 1.16. Brahim Hetemaj, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, anëtar;
- 1.17. Gani Sylaj, Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, anëtar;
- 1.18. Gëzim Ademaj, Menaxher i Prokurimit, anëtar;
- 1.19. Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit Komunal, anëtare.

2. Grupi punues do të bëjë hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit për vitin fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2021; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin e Planit të veprimit të cekur me lartë dhe pas përfundimit kopjen e Planit të Veprimit do t'ia dorëzojë Kryetarit; do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit që janë në natyrën e këtij Grupi punues.

3. Grupi punues i lartcekur, ka për obligim që Planin e veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit të hartoj për një kohë të shkurtë.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi punues.

Vendimi i dërgohet:

- Grupit punues dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-385/022	Data: Datum: 07.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-22438 të datës 06.06.2022 të parashtruar nga Fatmir Bicaj nga fsh. Vrellë, Komuna Istogu për ofrim të ndihmës financiare për shërimin jashtë vendi, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-22438 e datës 06.06.2022 e parashtruar nga z.**Fatmir Bicaj**, për ofrim të ndihmës financiare për shërimin jashtë vendi dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **900.00€ (nëntëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Fatmir Bicaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Fatmir Bicaj, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-22438 të datës 06.06.2022 me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin jashtë vendi.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Fatmiri është i sëmurë me sëmundje të zembrës dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për trajtim jashtë vendi që është i kushtueshëm.

I përmenduri e ka gjendjen ekonomike që nuk mund të përballoj financiarisht trajtimin jashtë vendit dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **900.00€ (nëntëqind euro)**.

Në plan programin buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë

u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

-Fatmir Bicaj,

-Drejtorisë për Shëndetësi dhe

-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-391/2022	Data: Datum: 07.06.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e datës 08.06.2022 të parashtruar nga Xhevat Demaj-Drejtor i Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim, për themelimin e Komisionit për dalje në vendin e ngjarjes për vlerësimin e dëmit material të shkaktuar nga rrufeja-djegia e shtëpisë së banimit të Faik Maraj nga fsh. Vrellë, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMEKOHET: Komisioni për dalje në vendin e ngjarjes për vlerësimin e dëmit material të shkaktuar nga rrufeja-djegia e shtëpisë së banimit të Faik Maraj dhe në Komision caktohen:

1. **Skender Hasangjekaj**, Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjencë, Kryesues i Komisionit;
2. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar dhe;
3. **Tahir Maksutaj**, Zyrtar për Monitorimin e Kamerave, anëtar.

2. Komisioni i cekura më lartë ka për obligim që të dalë në vend ngjarje dhe të bëjë vlerësimin e dëmit material të shkaktuar nga rrufeja-djegia e shtëpisë së banimit të Faik Maraj; të hartojnë procesverbalin në vendin e ngjarjes dhe të kompletojnë lëndën me dëshmi-foto të dëmeve; të njoftojnë Kryetarin e Komunës me ecurinë e vlerësimit të dëmit si dhe do t'i kryej punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Komisioni obligohet t'ia fillojë punën menjëherë si dhe merr përgjegjësi për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga rrufeja-zjarri.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-393/022	Data: Datum: 09.06.2022	

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyratë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin 11 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publik, shqyrtoj kërkesën e datës 06.06.2022 të parashtruar përmes imellës zyrtar nga Drejtori i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi i cili ka shqyrtuar kërkesën 03 Nr.016-21741 të datës 02.06.2022 të parashtruar nga Sami Podrimaj, Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4 në Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi, për lejin e pushimit mjekësor me pagesë prej 70% për tre muaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 03 Nr.016-21741 e datës 02.06.2022 e parashtruar nga **Sami Podrimaj**, Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4, për lejin e pushimit mjekësor me pagesë prej 70% për tre muaj, duke filluar nga data 02.06.2022 deri 31.08.2022, pasi që është i sëmur dhe mjeku i ka rekomanduar pushim për trajtim të sëmundjes.
2. I lartpërmenduri obligohet të paraqitet në punë me datën 01.09.2022, nëse i lartpërmenduri nuk lajmërohet më këtë datë në punë, konsiderohet se e ka braktis vendin e punës me vetë dëshirë.
3. **Obligohet Udhëheqësi i Personelit dhe Zyrtari Financiar-përgjegjës për paga, mëditje dhe kompensime të bëjë korrigjimin në listën e pagave për punëtorin në fjalë sipas pikës 1 të këtij Vendimi, si dhe mbas tre muajve nëse punëtori njofton që kthehet në punë të korrigjohet paga sipas pikës 2 të këtij Vendimi dhe të kthehet punëtori me pagë të plotë.**
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Menaxheri i Personelit dhe Zyrtari Financiar-përgjegjës për paga, mëditje dhe kompensime.

A r s y e t i m

Sami Podrimaj, Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4 ka parashtruar kërkesë 03 Nr.016-21741 të datës 02.06.2022 në Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi për lejin e pushimit mjekësor me pagesë prej 70% për tre muaj. Kryetari komunës shqyrtoj kërkesën e datës 06.06.2022 të parashtruar përmes imellës zyrtar nga Drejtori i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi si dhe kërkesën e të lartpërmendurit dhe të njëjtat i konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e lëndës-raporte mjekësore shihet se Samiu është i sëmur e që mjeku i ka rekomanduar pushim për trajtimin e sëmundjes.

Sami Podrimaj, i lejohet pushimi mjekësor me pagesë prej 70% për tre muaj, duke filluar nga data 02.06.2022 deri 31.08.2022 për shkak të sëmundjes së paraqitur me diagnozë si në raportin mjekësor. Obligohet Udhëheqësi i Personelit dhe Zyrtari Financiar-përgjegjës për paga, mëditje dhe kompensime të bëjë korrigjimin në listën e pagave për punëtorin në fjalë, sipas pikës 1 të këtij Vendimi, si dhe mbas tre muajve nëse punëtori na njofton që kthehet në punë të korrigjohet paga sipas pikës 2 të këtij Vendimi dhe të kthehet punëtori me pagë të plotë.

Për sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Sami Podrimaj,
- Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi
- Menaxherit të Personelit
- Zyrtarit Financiar-përgjegjës për paga, mëditje dhe kompensime dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01Nr.395/2022	Data: 09.06.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) i;

Propozon

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008), nenit 15 të i Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 - MPB për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi Shfuqizon: Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 - MPB - 02/2009 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësidhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 11) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10, në mbledhjen e mbajtur më: __.06.2022 mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

1. Më këtë Vendim Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi 01Nr.35/2022, i datës 31.03.2022 për themelimin e KKSB, për zëvendësimin e anëtareve me anëtar të ri, si në vijim :

1.1 Shtohet një përfaqësues nga Qendra Korrektuese Dubravë.

2. Anëtari i KKSB-së detyrat, përgjegjësitë dhe funksionin do t'i kryejnë bazuar në i Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 - MPB për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi Shfuqizon: Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 - MPB - 02/2009 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
3. Anëtari i KKSB-së ka mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.
4. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit 01Nr.35/2022, i datës 31.03.2022
5. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, anëtarët e KKSB-së dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

Kryetari i Komunës,
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-398/2022	Data: Datum: 13.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 10.06.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Ndërtimi i Qendrës Rinore në fsh. Uçë”; nxjerr:

V E N D I M

- CAKTOHEN:** Menaxheret e kontratës **znj.Burbuqe Pepaj**, Inspektore e Ndërtimit në Drejtorinë për Inspektion dhe **z.Naim Sadriu**, Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim në Drejtorinë Komunale për Arsim dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherëve të kontratës **CAKTOHET: znj.Elianë Blakaj**, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e Menaxherit të kontratës, për projektin: “Ndërtimi i Qendrës Rinore në fsh. Uçë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-3836-5-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-013-521, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori “Detari” SH.P.K nga fsh. Batllavë Komuna e Prishtinës.
- Menaxheret e kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherëve të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marrin Menaxheret e kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherive të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- znj. Burbuqe Pepaj, Menaxhere e Kontratës;
- z.Naim Sadriu, Menaxher i kontratës;
- znj.Elianë Blakaj, Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës
- "Detari" SH.P.K, operator dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-399/2022	Data: Datum: 13.06.2022	

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-423/022	Data: Datum: 22.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 12 të Rregullores Komunale 01/2014 për Ndarjen e Subvencioneve, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.130/2022 të datës 21.06.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për shpalljen e thirrjes publike për subvencionimin e fermerëve dhe për ndarjen e mjeteve buxhetore, për ngritjen e pemishteve me pemë dru frutore (kumbulla dhe qershi) dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 09 Nr.130/2022 e datës 21.06.2022 e parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për shpalljen e thirrjes publike për subvencionimin e fermerëve dhe për ndarjen e mjeteve buxhetore për ngritjen e pemishteve me pemë dru frutore (kumbulla dhe qershi).

2. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, obligohet që në kohë me të shkurtër të publikoj thirrjen publike për subvencionimin e fermerëve dhe të ndanë mjete buxhetore në shumë prej **40,000.00€ (katër dhjetë mijë euro)** 20,000.00€ për pemë dru frutore kumbulla dhe 20,000.00€ për pemë dru frutore qershi, nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe përgjegjës për zbatimin e tij është: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

4. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-425/022	Data: Datum: 22.06.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13- nenin 58 pika f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 4 paragrafi 2 nenparagrafi 2.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2018 për caktimin e Stafit Mbështetës, për emërimin e Zyrtarit për logjistikë (shofer), nxjerr:

V E N D I M

1. **I VAZHDOHET EMRIMI:** nga mandati i kaluar **z.Sadik Demaj**, Zyrtarë për logjistikë (shofer), me mandat të Kryetarit të Komunës, i cili është me vendbanim në fshatin Dubovë e Vogël, Komuna e Istogut,
2. I lartpërmenduri e vazhdon punën e Zyrtarit për logjistikë (shofer), i cili do të punoj me orar të plotë të punës dhe ka të drejtë ti shfrytëzoj pushimet në përputhje me Ligje dhe akte nënligjore në fuqi.
3. Obligohet Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për aga mëditje dhe kompensime, që këtë Vendim të dërgoj në Departamentin e pagave në Ministrinë Financave.
4. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij kujdeset Sadik Demaj.

Vendimi i dërgohet:

- z.Sadik Demaj,
- Financiare-përgjegjëse për aga mëditje dhe kompensime,
- Menaxherit të Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-426/022	Data: Datum: 22.06.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 10 pika b) të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008) dhe Ligji 06/L-021 për kontrollin e financave publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008, për emërimin e Zyrtarit zëvendësues-alternativ të Zyrtarit Kryesor Financiar, nxjerr:

V E N D I M

1. **EMROHET: Arta Fetahu**, Zyrtar zëvendësues-alternativ i ZKF-së e cila ka pozitën e punës Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim.
2. E lartëpermëndura, mund të ja filloj menjëher me ushtrimin e të gjitha përgjegjësiqve që i lejohen me Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjin e Buxhetit dhe aktet tjera nënligjore duke përfshirë shkresën qarkore të datës 12.01.2021 deri në kthimin e ZKF-së në detyrë.
3. Obligohen që të përdor SIMFK sipas Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Arta Fetahu dhe ZKF.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- ZKF,
- Arta Fetahut dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	01 Nr.428/022	Data: 27.06.2022	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin 10 të Rregullorës Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrat e Publikë, shfuqizoj Vendimin 01 Nr.57/2021 të datës 26.02.2021 të Komisionit disiplinor dhe për themelimin e Komisionit Disiplinor, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni Disiplinor në Shërbimin Civil, me mandat 3 (tre) vjeçar dhe në këtë komision caktohen:

- 1.1. Hatigje Arifaj,** Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Enisa Ćorović,** Zyrtare për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve, anëtar dhe
- 1.3. Fatmir Bytyçi,** Menaxher i Personelit anëtar.

2. Komisioni ka kompetencë të bëjë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura si dhe ka kompetencë të përcakton dhe shqipëton masën disiplinore, duke u bazuar në Rregullorën me Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrat e Publikë.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij kujdeset Komisioni.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ**




**Kryetari Komunës
z.Illir FERATI**



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-429 /022	Data: Datum: 27.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 12 par 12.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenin 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet, Komisioni i Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc, shqyrtoi kërkesën Nr.06-016/17706 të datës 06.05.2022, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Pejës, për lejin e strehimit të përhershëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Nushe (Metaj) Mujaj nga fshati Jabllanicë e vogel, Komuna e Pejës dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-016/17706 e datës 06.05.2022, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Pejës, për lejin e strehimit të përhershëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Nushe (Metaj) Mujaj, me nacionalitet shqiptar, me shtetësi kosovar e lindur me 01.01.1935, në fshatin Jabllanicë, Komuna e Pejës.
2. Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin e pëkohëshëm për 6 muaj me mundesin e rishikimit të gjëndjes për mundesin e vazhdimin të strehimit.
3. Shtëpia e Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndajë Nushe (Metaj) Mujaj, gjatë qëndrimit në këtë institucion.
4. Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së që të përcjell dhe të mbikqyrë gjëndjen e klientit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.
5. Vendimi është përfundimtar.

Arsyetim

Komisioni i Drejtorinsë për Mirëqenie Sociale shqyrtoj, kërkesën Nr.06-016/17706 të datës 06.05.2022 e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Pejës, për strehimin e të moshuarëve, shqyrtoi dosjën e Nushe (Metaj) Mujaj e cila jeton në Jabllanicë e Vogel në shtëpi e vetëm por në oborr të përbashkët me Kunatën Razen dhe familjen e saj, por që një vit Nusha ka nevojë për mbikqyrja pasi ajo është e palevizeshme e që për të kujdeset vajza e kunatit Resmija e cila e ka familjen e saj por që jeton aty afer në fshatë.

Gjendja shëndetësore e saj për momentin është e mirë pa probleme mendore, statusi familjar nuk ka bashkëshortë fëmijë biologjik as të adoptuar nuk ka vëllezër as motra.

Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin e pëkohëshëm për 6 muaj me mundesin e rishikimit të gjëndjes për mundesin e vazhdimin të strehimit dhe ka konstatuar se duhet t'i lejohej strehimi institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Palë e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Nushe (Metaj) Mujaj,
- Drita Kelmendi Kukaj-Drejtoresh e QPS-së në Pejë,
- Haki Ibrahimaj, Drejtor i QPS-së në Istog,
- Menaxheri i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 430/2022	Data: Datum: 27.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-22746 të datës 07.06.2022, të parashtruar nga z.Zeqir Blakaj, nga fsh.Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-22746 e datës 07.06.2022 e parashtruar nga z.Zeqir Blakaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(Radioterapisë) dhe i lejohen 50 litra karburant për dy (2) muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Zeqir Blakaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Zeqir Blakaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-22746 të datës 07.06.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se z.Zeqir Blakaj; është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij në Prishtinë për marrjen e kimioterapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Zeqir Blakaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarët të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-432 /2022	Data: Datum: 28.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-25061 të datës 21.06.2022, të parashtruar nga znj.Ryva Kabashi nga fsh.Tomoc, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-25061 të datës 21.06.2022, e parashtruar nga znj.Ryva Kabashi, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore (Kimioterapisë), dhe i lejohen 250 litra karburant, për t'i mundësuar udhëtimin e saj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë znj.Ryva Kabashi, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

znj.Ryva Kabashi, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-25061, të datës 21.06.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Ryva Kabashi, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- znj.Ryva Kabashi,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-433/2022	Data: Datum: 29.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 29.06.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Furnizimi i shkollave me rrjet të internetit 21 Loto”; nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës z.**Agron Zeqiraj**, inxhinier informatikës në SHFMU “Bajram, Curri” në Istog dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës z.**Naim Behlulaj**, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim, për projektin: “Furnizimi i shkollave me rrjet të internetit 21 Loto”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-3794-1-2-1/ C557 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-010-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori ELEKTRA L.L.C. nga Hani i Elezit.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z.Agron Zeqiraj,, Menaxher i kontratës
- z.Naim Behlulaj-Mbikëqyrës i Drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-435/022	Data: Datum: 29.06.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13, nenin 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.135 të datës 29.06.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për themelimin e Shtabit Komunal për korrije-shirje për realizimin me sukses të korrije-shirjeve në territorin e Komunës së Istogut dhe nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Shtabit komunal për korrije-shirje për realizimin me sukses të korrije-shirjeve në territorin e Komunës së Istogut dhe në Shtab caktohen:

- 1.1. **Astrit Hajrizaj**, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, Kryesues i Shtabit Komunal;
- 1.2. **Xhevat Demaj**, Drejtor i Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar;
- 1.3. **Fadil Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, anëtar;
- 1.4. **Skender Hasangjekaj**, Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjencë, anëtar;
- 1.5. **Rasim Mahmutovic**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
- 1.6. **Valbone Kaligani**, Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare;
- 1.7. **Haki Belaj**, Inspektor për Parandalimin nga Zjarri, anëtar dhe
- 1.8. **Dardan Blakaj**, Zyrtar për Subvencione, anëtar.

2. Shtabi për korrije-shirje obligohet të përcjell fushatën e korrije-shirjeve në tërë territorin e komunës; do të kujdeset që korrije-shirjet të realizohen me sukses dhe në afat; të gjitha mosmarrëveshjet në mes të kombanjerëve dhe fermerëve të zgjidhin me marrëveshje në mënyrë paqësore; të njoftoj rregullisht Kryetarin me ecurin e fushatës së korrije-shirjeve si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjerë të cilat janë në natyrën e këtij Shtabi Komunal.

3. Të gjitha punët administrative-teknike për nevojat e Shtabit do të kryejë Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Shtabi Komunal dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

5. Ky vendim është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Shtabit komunal për korrije-shirje,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
zni.Zekië SUTAJ




Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-436/022	Data: Datum: 29.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur në mes të komunës dhe OJQ “Vision 02” të datës 08.03.2022, Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, shqyrtoj kërkesën 12 Nr.400-20240 të datës 24.05.2022 dhe i propozon Kryetarit me shkresën 12 Nr.37/2022 të datës 01.06.2022 të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 12 Nr.400-20240 e datës 24.05.2022, e parashtruar nga OJQ “Vision 02” të cilën e përfaqëson Rexhë Mulaj, për përkrahje financiare për realizimin e projektit: “Të festojmë se bashku 24 Qershorin ditën e Egjiptianeve të Kosovës” dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **250.00€ (dyqind e pesëdhjete euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ-së “Vision 02” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

OJQ “Vision 02” ka parashtruar kërkesën 12 Nr.400-20240 të datës 24.05.2022, për përkrahje financiare për realizimin e projektit: “Të festojmë se bashku 24 Qershorin ditën e Egjiptianeve të Kosovës”.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e OJQ “Vision 02” dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

OJQ “Vision 02” ka kërkuar mjete financiare në shumë prej **500.00€**, por në mungesë të mjeteve financiare përkrahet financiarisht në shumë prej **250.00€** për shkak të rëndësisë së realizimin e projektit të cekur me lartë sipas projekt propozimit.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është i përcaktuar pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t’i transferohen në xhirollogarinë e OJQ “Vision 02”, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi..

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Regjië Mulaj, OJQ “Vision 02”;
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z.Illir FERATI


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-437/022	Data: Datum: 29.06.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 8 të Rregullores MF 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 12.Nr.49/2022 të datës 23.06.2022 të parashtruar nga e Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për licencim e Qendrave Rinore të publikuar në thirrjen publike të datës 25.05.2022, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim e Qendrave Rinore të publikuar në thirrjen publike të datës 25.05.2022 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Elianë Blakaj,** Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese e komisionit;
- 1.2. Genc Ademaj,** Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar;
- 1.3. Elmedina Shoshi,** përfaqësuese e KVRL-së, anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave për licencim e Qendrave Rinore; të njoftoj Kryetarin e Komunës me punën rreth shqyrtimit të kërkesave si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për shqyrtimin e të gjitha kërkesave për licencim e Qendrave Rinore e merr Komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

5. Vendimi është përfundimtar

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ**



**Kryetari Komunës
z.Illir FERATI**




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-440/022	Data: Datum: 30.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-23610 të datës 10.06.2022 të parashtruar nga Urim Morinaj, nga fsh.Serbobran, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-23610 e datës 10.06.2022 e parashtruar nga Urim Morinaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Urim Morinaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Urim Morinaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-10199 të datës 15.03.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Urim Morinaj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Urim Morinaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-441/022	Data: Datum: 30.06.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014; Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-18062 të datës 10.05.2022 të parashtruar nga Xhevdet Aliaj, nga fsh.Shushicë e Ulët, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për nënës (Ruke Aliaj), dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-18062 e datës 10.05.2022 e parashtruar nga Xhevdet Aliaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për vajzës (Ruke Aliaj) dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Xhevdet Aliaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiëve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Xhevdet Aliaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-18062 të datës 10.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për për vajzës (Ruke Aliaj).

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Ruke Aliaj është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim e nënës dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Xhevdet Aliaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-445/022	Data: Datum: 30.06.2022	

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13. dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 dhe Rregullores për Ndarjen Bursave për Studentë Nr.49/2017), për kompensimin e studentëve të cilët janë përfitues të bursave për vijimin e studimeve, nxjerr:

V E N D I M

- 1. NDAHEN:** mjete buxhetore në shumë prej 49,200.00 (katërdhjetëmijë e dyqind euro)për kompensimin e 82 bursave për student, për periudhën tetor 2021 shtator 2022.
- Kompensohen 36 bursist të ri në shumë të mjeteve financiare prej 21,600.00 dhe 46 bursist që janë vazhdim nga viti i kaluar kompensohen në shumë të mjeteve financiare prej 27,600.00€ nga fondi burimor 21, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsimit.
- Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do t'iu transferohen në xhirollogaritë e studentëve përfitues të bursave, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive,
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim-Zyrtari Financiar.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë Komunale për Arsim,
- Zyrtari Financiar dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-446/2022	Data: Datum: 30.06.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.122/2022 të datës 09.06.2022, të parashtuar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për themelimin e komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Ndërrimi i kroit në Lugun e Butë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-22-5112-5-4-7 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-018-5-4-7 nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: Ndërrimi i kroit në Lugun e Butë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-22-5112-5-4-7 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-018-5-4-7 të cilin e ka realizuat operatori AXIS G.C.W SH.P.K dhe në komision caktohen:

- 1.1. Bajram Sejdiqaj,** Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Qendrim Kajtaçaj,** Zyrtar për Subvencione, anëtar dhe
- 1.3. Ramë Blakaj,** Teknik i Gjuetisë, Pylltarisë dhe Peshkimit, anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; do të hartojë raportin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.

3. Përgjegjësin për pranimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë, pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

5. Vendimi është për përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ


